REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 78/17
Datë/Datum. 31.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **"Akademia e Shkencave dhe Arteve te Kosovës"**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr. 78/17.**
Nga:	Zenel Hisenaj – Ekspert Teknik Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Blerja e Kompjuterëve"**, me nr. të Prokurimit: **231/17/003/136.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**"ARITECH" Sh.p.k - Livaxhe**		
Datë	**31.03.2017**		

Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Blerja e Kompjuterëve"** me nr. të Prokurimit: **231/17/003/136,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **"Akademia e Shkencave dhe Arteve te Kosovës",** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatoreve ekonomik: **"ARITECH" Sh.p.k - Livaxhe** me nr. prot. **78/17,** të datës **16.03.2017.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES - TEKNIK

		27.03.2017		**28.03.2017**		**31.03.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit:

Me datën 16.03.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **78/17,** e parashtruar nga OE **"ARITECH" Sh.p.k - Livaxhe**, lidhur me aktivitetin të prokurimit **"Blerja e Kompjuterëve"** me nr. të Prokurimit: **231/17/003/136**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Akademia e Shkencave dhe Arteve te Kosovës.**

Konform nenit 113 dhe 114 Pjesa IX e LPP-së, si dhe vendimit nr. 712/15, të nxjerra nga paneli shqyrtues në lidhje me shqyrtimin e ankesave, Eksperti teknik-shqyrtues, e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjale si më poshtë

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues "ARITECH" Sh.p.k me seli në Livaxhe.

Pikat e Ankesës nga OE **"ARITECH" Sh.p.k** nga **Livaxhe**, *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Supozojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur:

1. **Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtese**

Autoriteti kontraktues mund te ftoj operatoret ekonomik për te plotësuar apo te qartësuar certifikatat dhe dokumentet e paraqitura ne pajtim me nenet 65-71 te këtij ligji

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtese

Ne siç kemi përmendur edhe me lart rne dt.03 mars 2017 kemi pranuar nga AK njoftimin për tenderuesin e Eliminuar.

Arsyet e Eliminimit te AK ndaj operatorit tone Ekonomik janë:

1. Oferta juaj nuk është sipas kërkesave të ASI-IAK në këto pozicione:

a) Keni ofruar procesorë me shpejtësi me të ulët nga ai i kërkuari;

b) Monitori i ofruar është më i vogël nga ai i kërkuari.

Ne kemi ofruar sqarimet duke argumentuar qe kërkesat apo arsyet e eliminimit tone rreth kërkesave te AK si ne vijim nuk qëndrojnë:

Për piken a) Keni ofruar procesorë me shpejtësi më të ulët nga ai i kërkuari

Ne kemi argumentuar qe specifikat për procesor janë edhe me te mira te ofertuar sesa vet kërkesa e AK.

Ndërsa për piken b) Monitori i ofruar është më i vogël nga ai i kërkuari.

Po ashtu ne kemi argumentuar qe madhësia e monitorit është identike nga sa është edhe kërkuar ne dosje te tenderit nga AK ashtu siç mund te shihet me poshtë.

Kërkesa ne dosje te tenderit rreth specifikave për Procesor është:

Processor: Intel N3050

Sipas kërkimeve te thjeshta gjejmë qe procesori sipas kërkesës suaj i ka këto specifika:

Intel(R) Celeron(R) CPU IV3050 @ 1.60GHz

Socket: *FCBGA 1170*

Clockspeed: *1.6 GHz Turbo Speed: 2.2 GHz*

No of Cores: *2*

Typical TDP: *6 W*

Për me shume mund te shihni ne linkun ne vijim rreth specifikave te procesorit sipas kërkesave tuaja:
http://www.cpubenchmark.net/cpu.php?cpu=lntel+Celeron+N3050+%40+1.60GHz

Oferta jone paraqet specifikat e procesorit si ne vijim:

Intel(R) Celeron(R) CPU J1800 @ 2.41GHz

Socket: FCBGAf170

Clockspeed: 2.4 GHz

Turbo Speed: 2.6 GHz

No of Cores: 2

Typical TDP: *10 W*

Për me shume mund te shihni ne linkun me poshtë rreth specifikave te procesorit sipas ofertës sonë te dorëzuar:

https://www.coubenchmark.net/cpu.php?cou=lntel 18C0+0/04 C+2.41 GHz

Sipas linqeve me lart vlerësimi i procesorëve sipas pikëve për këto dy lloje te procesorëve është:

Intel(R) Celeron(R) CPU J1800 @ 2.41GHz/ 1022 Pike

Inte/(R) Celeron(R) CPU N3050@ 160GHz/ 891Pike
Siç mund te shihet sipas krahasimeve te specifikave te procesorëve me lart oferta jonë paraqet specifika edhe me te mira sesa kërkesa e Autoritetit kontraktues.

Ndërsa rreth specifikave te Monitorit:
Kërkesa apo specifikat e kërkuara për Monitor nga Autoriteti Kontraktues janë:
"Equivalent" me View Sonic VA 2265S- 3 LED 22"Fu11
Sipas kërkimeve te thjeshta gjejmë specifikat si ne vijim:
Type : 21.5" TFT VA LCD
Për me shume shih linkun ne vijim:
http ://www.viewsoniceurope.com/uk/products/lcd/VA2265S-3.php

Monitori sipas ofertës sonë është si ne vijim:
ASUS -VS228NE
LCD display 21.5
Shih linkun e prodhuesit ne vijim:
https://shop.t-online.de/out/pictures/media/pds/asus-vs228ne-produktdatenblatt(1).pdf
Kërkesa e AK është identike edhe për nga madhësia me ofertën tone te dorëzuar.
Sipas krahasimeve me lart rreth madhësisë se monitorit mund te themi qe te dy monitorët janë te madhësisë se njëjtë sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktues.
Pas kërkesës sonë për Rishqyrtim dhe sqarimeve tona me lart ne me dt. 07 mars 2017 kemi pranuar përgjigjen nga AK duke hedhur poshtë argumentet tona dhe duke nxjerr tjera arsye për Eliminim.
AK nuk ka dhënë asnjë sqarim rreth argumenteve tona me larte për arsyet e eliminimit te cilat vetëm se janë te paqëndrueshme.
Arsyet tjera nga AK janë si ne vijim:
Pika 2. Operatoret Ekonomike, në kolonën " Artikulli qe ofertohet" duhet ti saktësojnë plotësisht artikujt e ofertuar te cilët do t'i sjellin po qe se shpërblehen me kontrate dhe,
Pika 3. Garancia duhet te mbulohet nga prodhuesi i pajisjeve
Ne me dt 08 mars 2017 kemi kërkuar nga AK-ja te Rishqyrtoj vendimin e tij duke ofruar argumente rreth pikave tjera me lart.
Sa i përket kësaj pike ne i kemi qartësuar AK-se qe ne kolonën "Artikulli qe ofertohet" ne përveç qe kemi përshkruar llojin e produktit te ofertuar saktësisht ne ju kemi bashkangjitur edhe broshurën e produkteve qe kemi ofertuar.

Ndërsa sa i përket pikës tjetër rreth Garancionit sipas kërkesës ne dosje gjejmë:
Pika 3. Garancia duhet të mbulohet nga prodhuesi i pajisjeve.
Në broshurën e dorëzuar figuron mbulimi i Garancionit te Prodhuesit ashtu siç është kërkuar ne dosje, përveç kësaj ne kemi nënshkruar dhe vulosur edhe një deklarate me te cilën garantojmë rreth Garancionit ne fjalë
Ne mendojmë qe Broshura e prodhuesit është qe bën mbulimin e garancionit për te dy produktet kryesore.

Për te dy pikat tjera ne kemi bashkangjitur ne e-mail (broshurën e dorëzuar) duke nënvizuar qe Prodhuesi mbulon garancion e kërkuar nga AK-ja si dhe ne kolonën artikulli po ashtu bashkangjitur duke rrumbullakosura produktet e saktësuara ashtu siç është kërkuar ne dosje.
EDHE SIKUR TE KISHTE PASUR NDONJE INFORMACION QE DO TE KISHTE MUNGUAR (qe ne rastin konkret nuk ka qene), BAZUAR NE LIGJIN PER PROKURIM PUBLIK, NENI 72 DO TE DUHEJ KERKUAR SQARIM!
Ne pas sqarimeve tona kemi pranuar e-mail me dt. 10 mars 2017 nga prokurimi përkatësisht nga AK ku thuhet:
Citim:
ASHAK e ka kërkuar produktin "Ekuivalent me ACER dhe për këtë e ka përzgjedhur ACER se eshtë "Brand NAME" ne prodhimin e PC-ve.
Pas hulumtimit te tregut ka përzgjedhur konfiguracionin me te përshtatshëm profesional për buxhetin e parapare.
Produkti juaj nuk i përmbush këto kërkesa.
Deklarata juaj dhe garancia e nënshkruar nga ju nuk e përmbush kërkesën e ASHAK, pasi qe nuk eshtë e vërtetuar nga prodhuesi. Përfundim Citati.
bashkangjitur keni ne tërësi shkresën e AK-se
Ne me dt. 13 mars 2017 ne përpjekje per te zgjidhur dhe per te lehtësuar ndryshimin e vendimit te AK-se kemi ofruar edhe nje argument shtese me qellim zgjidhjen e mosmarrëveshjes – Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.
AK-se iu kemi bashkangjitur dhe certifikata dhe deklarata te konfirmitetit per te dëshmuar qe produkti jone i permbush te gjitha kerkesat e AK-se dhe eshte nga prodhuesi BRAND NAME
Bashkangjitur keni te gjitha certifikatat e dërguara tek AK.
LUSIM ORGANIN TUAJ QË KËTË LENDE TA KTHEJ NË RIVLERËSIM

Demi Material

Dëme materiale direkte është humbja e fitimit te mohuar dhe kostot operacionale për ndjekje te këtij rasti.

Propozimi

Te kthehet lënda ne RIVLERESIM.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	21.02.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	E kuotimit të çmimeve
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Furnizim/vlerë e vogël
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	02.03.2017
Data e hapjes së ofertave	02.03.2017
Data e anulimit te dhënies se Kontratës:	*06*.03.2017

Kriteret për vlerësim:

II.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Deklarata nën betim se ju i përmbushni kërkesat për përshtatshmëri sikurse është cekur në nenin 65 të Ligjit LPP-Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092
2. Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës.
3. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë"- të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1.Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit, Aneksi 2 (Origjinal).

2.Vërtetimin nga Administrata Tatimore (kopje).

3.Vërtetimin nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit).

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
2. Regjistrimi në TVSH; dhe
3. Regjistrimi i Numrit Fiskal.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një kopje e certifikatës së biznesit;
2. Një kopje e certifikatës së TVSH; dhe
3. Një kopje e certifikatës se numrit fiskal.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar N /A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 1: Kontrata të realizuara të natyrës së ngjashme, në (3) tre vitet e fundit (2014, 2015 dhe 2016), minimumi dy (2) kontrata.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia dokumentare

1. Listën e shërbimeve (kontratave) të realizuara së bashku me 2 (dy) referenca përkatëse të natyrës së ngjashme në 3 (tre) vjetët e fundit (2014, 2015, 2016).

IV.1.1) Lloji i procedurës ☒ Kuotim i çmimit

IV.2) KRITERET E DHËNIES ☒ Çmimi më i ulët

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	Ilir Kosova SHPK	Prishtinë	3,112.20 €	JO
2.	Bootek SHPK	Prishtinë	4,311.00 €	JO
3.	ARITECH SHPK	Prishtinë	2,943.00 €	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 02.03.2017, *konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë katër (3) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.*

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Dafina Kavaja
- - Anëtar i komisionit - Burim Rexhepi
- - Anëtar i komisionit – Rejhane Islami

Data e mbarimit të vlerësimit: 02.03.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....02.03.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

1. **Ilir Kosova** – Nuk ka plotësuar formularin e paraqitjes se kuotimit te çmimit. Mungon emri i Autoritetit Kontraktues, titulli i prokurimit dhe numri.
2. **Bootek** – nuk ka plotësuar formularin e paraqitjes se kuotimit te çmimit, Mungon emri i AK-se, Titulli i prokurimit dhe numri, çmimi i ofruar nuk është i nënshkruar ne formularin C nga OE.
3. **ARITECH SHPK** – ofron procesor me shpejtësi me te ulet, Monitori i ofertuar është 21.5 me i ulët se kërkesa e ASHAK.

Komisioni merr këtë vendim: asnjeri nga operatoret ekonomik nuk ishte i përgjegjshëm ndaj kërkesës se ASHAK dhe qe procedura te anulohet ne mungesë te ofertës se përgjithshme.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues - teknik (N. 306) :

Eksperti shqyrtues sqaron:

Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedur koutimit, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi përgjegjshëm çmimi më i ulët". I pakënaqur me njoftimin për anulim të datës 06.03.2017, për këtë aktivitet të prokurimit, operatoret ekonomik ankues, ka parashtruar ankes në OSHP, me datë 16.03.2017, me pretendimet ankimore se nuk janë respektuar neni:

Neni 72 i LPP-së, (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë), si dhe specifikimi teknike në lidhje me kriteret.

Ne interpretim të asaj që u tha më lartë, po sqarojmë se i kemi shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndes, konkretisht ato që lidhen me zbatim të vendimit të lartë përmendur (pretendimeve ankimore)

dhe atë si në vijim:

Eksperti Teknik pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarim nr. 1

Bazuar ne kërkesën e AK-se konkretisht faqe 11 te dosjes se tenderit te njëjti kërkojnë:

Nr. Rend	Artikulli	Njësia matëse	Sasia
1.	**Kompjuter personal "Ekuivalent" me ACER Aspire SFF** **Karakteristikat e detyrushme** **Procesor:** Intel N3050 **Hard disk drive:** HDD SATA 500 GB **Graphics:** Intel R HD Graphics **Tastiera:** QËERTY **Mouse:** Optical 3 button scroll **Monitori: "Equivalent" me vieë Sonic VA 2265S- 3 LED 22'' Full** Garancia: 3 vjet	copë	9 copë

Oferta e Operatorit Ekonomik ankues për këtë procedure ishte:
Oferta për Monitor



DATASHEET MSGW Infinity Series

ASUS

Monitor

VS228NE

VS228NE
EAN: 4716659502425
PN: 90LMD8001T02211C-

Hardware

Gerätetyp	LCD-Display / TFT-Aktivmatrix
Hintergrundbeleuchtung / Paneltyp	WLED / TN
Max. Auflösung / Full-HD	1920 x 1080 / Ja
Diagonalabmessung	54,6 cm (21,5") - Breitbildformat
Kontrastverhältnis	50.000.000:1 (dynamisch)
Max. Blickwinkel	90° horizontal - 65° vertikal
Reaktionszeit	5ms
Seitenverhältnis des Bildes	16:9
Helligkeit	200 cd/m²
Punktabstand - Pixelabstand	0,248 mm
Farbunterstützung	16,7 Millionen Farben
Farbe	Schwarz
Features + Besonderheiten	/
Bildschirmpositionsanpassung	Neigbar
Abmessungen (BxTxH) / Gewicht	51,4 x 38,6 x 20 / 5,9 kg
Schnittstellen	D-Sub, DVI-D
Stromverbrauch Betrieb - Standby	max. 25 Watt / max. 0,5 Watt
Zubehör	DVI-Kabel, VGA-Kabel, Netzkabel
Garantie:	3 Jahre

Full HD 1080 | 16.7M colors | 5ms | Ultra Slim

M SAN Grupa d.d., Buzinski prilaz 10, 10020 Zagreb-Buzin
Tel.: ++ 385 1 365 49 00 Fax: ++385 1 365 49 05
http://www.msan.hr E-mail:msan@msan.hr

MSAN W

2

Oferta për Kompjuter

DATASHEET MSGW Infinity Series

M SAN GRUPA

Specification	Model: MSGW Infinity sp1120	
Processor:	Intel® Dual-Core Celeron J1800	
Chipset:	Intel®	
Memory:	1 x 4 GB DDR3L 1600 MHz 2 x SO-DIMM, Max. 16GB, DDR3 1600/1333/1066 Hz Non-ECC, Un-buffered Memory Dual Channel Memory Architecture	
Graphic:	Intel® HD graphics	
Audio:	On board 5.1 CH HD Audio (Realtek ALC662 Audio Coder)	
Hard disk:	1 x HDD 500GB, SATA 6 Gb/s, 32MB cache, 7200 rpm 2 x SATA 3Gb/s ports	
LAN:	On Board Gigabit LAN Controller	
I/O Ports:	Back: 1 x PS/2 keyboard 1 x PS/2 mouse 1 x VGA 1 x HDMI 1 x LAN (RJ-45) port 1 x USB 3.0 3 x USB 2.0 1 x COM Port on-board 1 x Parallel port 3 x Audio jacks	Front: 2 x USB 2.0 1 x Microphone jack 1 x Headphone jack
Internal connectors	1 x COM Port Header 1 x TPM Header	
Expansion Slots:	1 x PCIe 2.0 x1	
Chassis / Power supply:		
Chassis Type options:	Midi tower 2 x 5.25" external, 1 x 3.5" external, 2 x 3.5" internal, 5 x 2.5" internal	
Power supply:	500W silent	
Certificates:		
Certified for:	CE, RoHS, WEEE, Energy Star 6.0 (optional)	
Software:		
Operating system:	Free Dos	
Security:		
Security:	Boot sequence control, BIOS password, BIOS access control of input/output ports	
Keyboard / Mouse:		
Keyboard:	Usb International keyboard	
Mouse:	Usb Optical mouse	
Speakers:	Optional	
Warranty:		
Warranty:	36 months	

The information contained herein is subject to change without notice and is provided "as is" without warranty of any kind. The warranties for M San Group Products are set forth in the express limited warranty statements accompanying such products. Nothing herein should be construed as constituting an additional warranty. M San Group shall not be liable for technical or editorial errors or omissions contained herein. MSGW Infinity Series is a trademark of M San Group. Microsoft, Windows is a registered trademark of Microsoft Corporation. Intel, Pentium, Celeron and Atom Technology are registered trademarks of Intel Corporation. M San Group disclaims proprietary interest in the trademarks and names of others. © 2011 M San Group. All rights reserved.

M SAN Grupa d.d., Buzinski prilaz 10, 10020 Zagreb-Buzin
Tel.: ++385 1 365 49 00 Fax: ++385 1 365 49 05
http://www.msan.hr E-mail: msan@msan.hr

MSGW 2

Duke u bazuar ne këto dokumente konsideroj se OE plotëson te gjitha kërkesat e AK-se, për faktin se edhe ne dosjen e tenderit ka përdorur fjalën "Ekuivalente"

Duke u bazuar ne këto dokumente konsideroj se OE plotëson te gjitha kërkesat e AK-se, për faktin se edhe ne dosjen e tenderit ka përdorur fjalën "Ekuivalente"

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 72 të LPP-së, për plotësim dokumentacionit dhe informacionit shtesë, vlerëson se është e drejtë e autoritetit kontraktues të kërkoj informacion apo dokumentacion shtesë në harmoni me nenin e lartë cekur (neni 72 i LPP-së).
Eksperti shqyrtues duke u bazuar në konstatimin e ekspertit teknik në lidhje me specifikimet teknike sa i përket OE ankues, vlerëson se Autoriteti kontraktues NUK ka bërë ekzamininimin , krahasimin dhe vlerësimin e ofertave konkretisht OE ankues në harmoni me kriteret e FDT-së, sa i përket specifikimit teknike, sepse i njëjti OE ankues ka ofertuar në harmoni me kriteret e FDT-së, sa i përket specifikimit teknik të ofertës së tij.

Mendimi i ekspertit teknik:

Eksperti shqyrtues-teknik, bazuar në s'qarimet e cekura ne raportit të ekspertizës mendon që Autoriteti Kontraktues – Akademia e Shkencave dhe Arteve te Kosovës (ASHAK), për aktivitetin e prokurimit **"Blerja e Kompjuterëve",**, me nr. të Prokurimit: **231/17/003/136**, REKOMANDOJM panelin shqyrtues që të ANULOJ Njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit i datës 16.03.2017, si dhe njëherit të kthehej në ri-vlerësim këtë aktivitet të prokurimit.